Grante për Fuqizimin Ekonomik të Grave – Punësim për gra të Margjinalizuara

FACTSHEET #1 **JANAR 2015**

SHIFRAT ME NJË TË PARË

7

Organizata Shqiptare Jo Fitimprurëse kanë rritur kapacitetet e tyre për të trajtuar fuqizimin ekonomik të grave të margjinalizuara.

388*

gra të margjinalizuara u trajnuan në tema dhe aftësi të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin mbi të drejtat e tyre dhe për të rritur mundësitë e tyre të punësimit.

184*

gra të margjinalizuara janë punësuar ose vetëpunësuar.

7

rrethe të Shqipërisë kanë gra më të informuara mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre.

960*

përfitues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë - Familjet e grave të margjinalizuara

PËRMBLEDHJE

Shumë gra të cënuara ose të margjinalizuara vuajnë nga mungesa e arsimimit, dhe edhe ato prej tyre që kanë ndjekur arsim të mesëm shpesh herë nuk kanë aftësi të vlefshme për tregun e punës.

Këto gra nuk janë të mësuara me kërkesat e një pune tetë orëshe jashtë shtëpisë, kështu që dhe n.q.s. arrijnë të punësohen, stresi i kësaj situate të re i gërshetuar me kërkesat e larta të bashkëshortit dhe pjestarëve të tjerë të familjes mund ti shtyjnë ato ta lënë punën. Gratë e cënuara, sidomos mbijetueset e dhunës në familje ose të diskriminimeve të tjera, kanë nevojë për trajnim të specializuar dhe mbështetje të vazhdueshme për të ndryshuar situatën e tyre. Trajnimet për të rritur ndërgjegjsimin mbi të drejtat e njeriut, dhunën në familje, vetëbesimin, si dhe për aftësi konkrete punësimi, janë të gjitha mjete të nevojshme për të gjetur dhe mbajtur një punë ose për gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet vetëpunësimit.

Edhe pse gratë e cënuara e të pakualifikuara vuajnë prej mungesës së vendeve të punës, mundësi punësimi ekzistojnë. Shumë sektorë ofrojnë mundësi për punësim ose vetëpunësim për gratë me kualifikim të ulët, duke përfshirë industrinë e veshmbathjeve dhe turizmit.

ARRITJET

Assist Impact punoi me shtatë OJF shqiptare për të adresuar çështjet që lidhen me gratë e margjinalizuara në zonat urbane, gjysmë-urbane dhe rurale të Shqipërisë. Nëpërmjet këtij programi grantesh gra të cënuara u identifikuan fillimisht në zonat e synuara. Çdo OJF studioi situatën e punësimit në zonat e tyre përkatëse dhe kërkesat për punonjës në sektorë të ndryshëm.

Gratë e identifikuara (388 gra në shtatë rrethe të Shqipërisë) u përfshinë në trajnime për rritje aftësish dhe aktivitete për rritje ndërgjegjësimi si më poshtë:

- Trajnimet për rritjen e aftësive profesionale përfshinë këto fusha: gatimin, pastrimin, kultivimin e fruta-perimeve dhe manaxhimin e serrave, mbarështrimin e dhive, veprimtarinë e hoteleve dhe krijimin e punëve artizanale.
- Paralelisht u mbajtën një sërë aktivitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për rritjen e njohurive mbi dhunën në familje, të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e të paturit një punë dhe/ose të gjeneruarit të të ardhurave. Pjesë të këtyre aktiviteteve përfshinë dhe pjestarë nga familjet e grave, burra dhe djem, në mënyrë që dhe ata ti kuptonin dhe mbështesnin ato.

Një mbijetuese e dhunës në familje tashmë e punësuar.

"Nga momenti që pamë këtë projekt kuptuam që duhet ti shtonim strategjisë tonë edhe mbështetjen për punësim gjatë përpjekjeve tona për të ndihmuar mbijetueset e dhunës në shtëpi."

— Iris Luarasi, Drejtoreshë Ekzekutive e Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza

** Ambasada Australiane dha një kontribut prej 12 dhish alpine për gratë në Mner të Sipërm.*

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE

AssistIMPACT

ARRITJET *vazhdim*

Një arritje kyçe ka qenë bashkëpunimi i suksesshëm me institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale për të rritur të kuptuarit e çështjeve të lidhura me gratë e margjinalizuara, si dhe për trajtimin e tyre brenda kapaciteteve të tyre institucionale. Shumë biznese private lokale u përfshinë dhe u informuan dhe shumë prej tyre ofruan punësim.

Ndërsa të shtatë OJF-të e përfshira gjithmonë kishin në plan trajnimin e më shumë grave se sa 188 që ishin vendosur si objektiv për tu punësuar apo vetë-punësuar, me 177 gra që u punësuan/vetëpunësuan u arrit 106% e objektivit. Të ardhurat fillojnë nga aktivitete në të cilat fitohen vetëm 60$/muaj në mënyrë sezonale e deri në punë me një pagë relativisht të mirë të 200-300/muaj. Gjithsesi nuk mund të nënvlerësohen aspak rëndësia e pjesëmarrjes së këtyre grave në aktivitetin ekonomik të familjes dhe kontributi sado modest i tyre për të ardhurat e familjes.

MBULIMI GJEOGRAFIK

Ky program grantesh përfshiu gra të margjinalizuara në zonat gjysmë-urbane dhe rurale të largëta në rrethet e mëposhtme:

- Tiranë
- Lezhë
- Pukë
- Elbasan
- Librazhd
- Gjirokastër
- Pogradec

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) • *Puke, Lezhë*

Shoqata për Integrim Gjinor • *Bastar i Mesëm, Mner i sipërm, Murrizë, and Vilëz*

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza • *Tiranë*

Fondacioni "Gjirokastra" • *Gjirokastër*

MEDPAK (Mbrojtja E të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara) • *Librazhd*

Shoqata e Artizanëve të Punimeve Artistike (ATACT) • *Pogradec*

Diakonia Agapes • *fshatrat Shushicë, Hajdaran, Milza and Shelcan*